

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "M.T.CONSTRUCTION" sh.p.k. me KAPITAL THEMELTAR 100.000 lekë

Matthaios Triantafyllos, banues në Kykladon të Greqisë, me shtetësi greke, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me nr. pasaporte 359089, mbështetur në ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare", dhe në ligjin nr. 7764, datë 02.11.1993 "Për investimet e huaja", si dhe në dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar, ka vendosur të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

#### Neni 1.

Shoqëria emërtohet "M.T.Construction" sh.p.k.

Selia e saj është në, Rruga "V. Pasha", P. 11 katsh, Shk. 1, Ap. 3/5, Tiranë. Mënyra e transferimit të selisë së shoqërisë rregullohet në Statutin e shoqërisë.

#### Neni 2

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "M.T.Construction" sh.p.k. është person juridik që vepron sipas legjislacionit shqiptar, të ketij akti themelimi dhe statutit të shoqërisë, që është pjesë përbërëse e saj.

Shoqëria përgjigjet vetëm me pasurinë e saj.

#### Neni 3


Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj : Import materiale ndërtimi, punime dheu, konstruksione beton-arme, muratura, punime fasadash, lysterje, ndërtime civile, industriale e turistike.

#### Neni 4

Shoqëria do të veprojë për 12 vjet

#### Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë. Ai zotërohet vetëm nga Matthaios Triantafyllos. Kapitali i shoqërisë ndahet në 10 pjesë me nga 10.000 lekë seicila pjesë.



Neni 6

Organet e shoqërisë janë :

1. Asambleja
2. Një administrator
3. Eksperti kontabël i autorizuar

Mënyra e krijimit dhe funksionimit të tyre përcaktohet në statut.


Neni 7

Shoqëria do administrohet nga Matthaios Triantafyllos.

Ky akt themelimi u përpilua sot më datën 30.09.1997 në Tiranë.

Ortaku i vetëm

Matthaios Triantafyllos



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË


Nr. 2770 rep.

Nr. 332 kol.

VËRTETIM

Sot, më datën 30.09.1997 u paraqit para meje Noterit Zollan Shkurbi i Dhomës së Noterëve Tiranë, Zoti Matthaios Triantafyllos, shtetas grek, i panjohur më parë prej meje, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me nr. pasaporte 359089, i cili më deklaroi se aktin e themelimit të shoqërisë "M.T.. Construction" sh.p.k. e ka firmosur me vullnetin e tij të lirë.

Unë Noteri duke e gjetur konform ligjit, bëra legalizimin e tij.



## STATUTI



### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "M.T.CONSTRUCTION" sh.p.k. ME KAPITAL THEMELTAR 100.000 LEKË

Matthaios Triantafyllos, banues në Kykladon të Greqisë, ka krijuar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "M.T.Construction" sh.p.k., konformë ligjit 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare", e cila gjithë veprimtarinë e saj do ta zhvillojë sipas legjislacionit në fuqi dhe statutit të kësaj shoqërie.

#### KREU I

*FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA, KAPITALI THEMELTAR.*

##### NENI 1

###### *FORMA*

Shoqëria do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.)

Shoqëria fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregëtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

##### NENI 2

###### *EMËRTIMI I SHOQËRISË*

Shoqëria emërtohet "M.T.Construction" sh.p.k.

##### NENI 3

###### *OBJEKTI I SHOQËRISË*

Objekti i shoqërisë është : Import materiale ndërtimi, punime dheu, konstruksione beton-  
arme, muratura, punime fasadash, lyerje, ndërtime civile, industriale e turistike.

##### NENI 4

###### *SELIA E SHOQËRISË*

Selia e shoqërisë është në Rr. "V. Pasha", P. 11 kash, Shk. 1, Ap. 3/5, Tiranë.

Selia e shoqërisë mund të transferohet në një adresë tjetër me vendim të ortakut të vetëm, i cili u njoftohet 10 ditë më parë të gjithë personave që kanë lidhje me të.

#### NENI 5

##### *KAPITALI THEMELTAR*

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kapitali themeltar ndahet në 10 (dhjetë) pjesë nga 10.000 (dhjetë mijë) lekë seicila pjesë.

Shoqëria përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar është derdhur në Bankën ku është marrë dhe dokumenti, i cili i bashkangjitet këtij statuti.

Mandatmbajtës për depozitim dhe tërheqjen e kapitalit themeltar në bankë është Matthaïos Triantafyllos.

Ortaku i vetëm për të shtuar kapitalin themeltar duhet të marrë vendim, i cili mbahet në dokumentat e shoqërisë.

#### NENI 6

##### *LËNIA DHE TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR*

Kapitali themeltar i shoqërisë është lehtësisht i transferueshëm në rast trashëgimie, ndarie pasurore midis bashkëshortëve dhe ndërmjetë paraardhësve dhe pasardhësve.

Pjesë të kapitalit themeltar të shoqërisë "M.T.Construction" sh.p.k. mund tu transferohen edhe të tjerëve të cilët bëhen ortakë në shoqëri.

Ortakët e rinj marrin përsipër të respektojnë statutin e shoqërisë si dhe detyrimet që ka shoqëria. Në të tilla raste bëhen ndryshimet përkatëse në statut, në regjistrin tregëtar dhe në librat e shoqërisë.

#### NENI 7

##### *KOHËZGJATJA*


Shoqëria do të veprojë për 12 vjet.

#### KREU II

##### *MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISË*

#### NENI 8

##### *MARRJA E VENDIMEVE*



Vendimet merren nga ortakut i vetëm. Vendimet e ortakut të vetëm janë dokumente që ruhen për gjithë kohëzgjatjen e shoqërisë.

Në rast se shoqëria, si rezultat i lënies ose transferimit të kapitaleve, ka disa ortakës atëherë marrja e vendimeve do të rregullohet sipas dispozitave të ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" dhe ndryshimeve e plotësimeve të këtij statuti.

#### NENI 9

##### *ADMINISTRIMI*

Administrator i shoqërisë është Matthaïos Triantafyllos.

Administratori ka kompetencë për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori formulon bilancin dhe llogaritë ekonomike, cakton likuidatorin në rastin e prishjes ose falimentimit të shoqërisë, firmos dokumentet e shoqërisë dhe e përfaqëson atë përballë të tretëve.

#### NENI 10

##### *KONTROLLI I SHOQËRISË*

Kontrolli i shoqërisë do të kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për tre vite financiare.

Eksperti kontabël i autorizuar caktohet me vendimin e ortakut të vetëm.

Në rast se vërehen gabime në punën e ekspertit kontabël të autorizuar, ortakut i vetëm me vendim mund ta shkarkojë nga detyra dhe para afatit atë.

### **KREU III**

#### *VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, NDARJA E FITIMEVE*

#### NENI 11

##### *VITI FINANCIAR*

Çdo vit financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Përgjatë vitit të parë financiar që fillon kur bëhet regjistrimi në zyrën e tatimeve dhe fillon aktiviteti.

#### NENI 12

##### *LLOGARITË VJETORE*



Llogaritë vjetore dhe inventari, si dhe puna tjetër që bën eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga ortakut i vetëm.

Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhen brenda një afati prej 6 muajsh nga data e përfundimit të vitit financiar.



#### NENI 13

#### *NDARJA E FITIMEVE*

Pasi zbriten gjithë shpenzimet që ka bërë shoqëria gjatë aktivitetit të saj, pjesa që mbetet është fitimi. Nga fitimi i realizuar do të lihet mënjandë fondi “rezervë e domosdoshme”, i cili është në masën 5 përqind të fitimit. Fondi “rezervë e domosdoshme” do të lihet mënjandë deri sa të arrijë 10 përqind të kapitalit themeltar.

#### KREU IV

#### *PRISHJA, LIKUJDIMI*

#### NENI 14

#### *PRISHJA*

Shoqëria përfundon veprimtarinë e saj mbas 12 vjetësh.

Ortakut mund ta prishë shoqërinë edhe para këtij afati për arsye të parashikuara në ligj.

#### NENI 15

#### *LIKUJDIMI*

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e kësaj pune ortakut i vetëm emëron një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin ortakut raportin për gjendjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë, gjendjen e operacioneve të likujdimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Pas likujdimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar të ortakut, likujduesi ndan kapitalet e mbetura në llogarinë e ortakut të vetëm.



KREU V  
DISPOZITAT E FUNDIT



NENI 16.

SHNDRIMI I SHOQËRISË

Shndrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të tjera bëhet me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 17

Të gjitha çështjet që dalin dhe nuk janë trajtuar në këtë statut, zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi e sidomos sipas ligjit "Për shoqëritë tregëtare".

*Themeluesi i shoqërisë*

**MATTHAIOS TRIANTAFYLLOS**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERISË TIRANË


Nr. 2771 rep.

Nr. 333 kol.

**VËRTETIM**

Sot, më datën 30. 09. 1997 para meje Noterit Jolles Skendo Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqit personalisht Zoti Matthaios Triantafyllos, i panjohur më parë prej meje, për identitetin e të cilit u sigurova nga letëmjoftimi që më paraqiti me nr. 359089, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i cili më deklaroi se e ka firmosur me vullnetin e tij të lirë statutin e shoqërisë "M.T.Construction".

Unë Noteri duke e gjetur konform ligjit, bëra legalizimin e tij.



Noteri  
Jolles Skendo